

Deri te:

Këshilli Mësimor Shkencor i Fakultetit të Kulturës Fizike të Universitetit të Tetovës

Në bazë të Vendimit të Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit të Kulturës Fizike në Universitetin e Tetovës, me nr. 19-34/1, nga mbledhja e mbajtur në datën 25.01.2019, për formimin e Komisionit për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës me titull “Analiza e pozicioneve të lojtarëve në basketboll në bazë të karakteristikave morfologjike dhe testeve aerobo-anaerobe” të kandidatit Mr.Sc. Artan R. Kryeziu, Komisioni në përbërje të: Prof. Dr. Besnik Telai-Kryetar, Prof. Dr. Metin Dalip - anëtar, Prof. Dr. Atli Koleci - anëtar, Prof. Dr. Visar Ganiu - anëtar, Prof. Dr. Isa Asllani - Udhëheqës.

Këshilli Mësimor Shkencor paraqet këtë:

Raport

Për vlerësimin e punimit të doktoraturës

Mr.Sc. Artan Kryeziu ka lindur me datën 18.02.1988 në Gjilan, shkollën fillore dhe të mesme i ka mbaruar në Gjilan, i diplomuar në Fakultetin e Kulturës, Fizike, Sportit dhe Rekreacionit në Kolegjin Iliria në vitin 2010. Ndërsa në vitin 2015 mbaroi Magjistrurën në Fakultetin e Kulturës Fizike në Universitetin e Tetovës dhe morri titullin Magjistër i Kulturës Fizike.

Përvoja profesionale:

Nga viti 2002 ka filluar që të ndjek procesin stërvitor në Klubin e Basketbollit “Drita” nga Gjilani, më pastaj ka vazhduar që të luaj në kategorinë e Kadetëve, Juniorëve dhe të Seniorëve pranë këtij klubi të basketbollit deri në 2008. Po ashtu në vitin 2011 ka filluar që të mbajë procesin stërvitor në cilësinë e ndihmës-trajnerit për junior dhe senior. Pastaj vazhdon prej vitit 2014 në akademinë e basketbollit “Prishtina Pro Basket” në Prishtinë në cilësinë e trajnerit për grup-moshat e reja.

Nga viti 2012 fillon të mbajë mësim në shkollën fillore dhe të mesme të ulët “Pjetë Bogdani” në Prishtinë, pastaj prej vitit 2014 në Gjimnazin “Hasan Nahi” në Prishtinë si dhe së fundi prej vitit

2016 në shkollën fillore dhe të mesme “European School of Kosova” në Prishtinë në cilësinë e mësimdhënësit të Edukatës Fizike, Sportit dhe Shëndetit.

Në nivelin universitar si ligjërues (mësimdhënës) i rregullt në Kolegjin FAMA, në programin Përkujdesia dhe Mirëqendja për fëmijë në lëndët: Metodologjia dhe Kultura Fizike, si dhe Sporti dhe Shëndeti, prej vitit akademik 15 tetor 2015 e tutje, si dhe bashkëpunëtor i jashtëm me angazhim-honorar në Universitetin “Kadri Zeka-Gjilan”, në Fakultetin e Edukimit në Programin Fillor dhe Parashkollor në lëndën Metodologjia e Edukimit Fizik prej vitit akademik 15 tetor 2016 deri 15 shkurt 2017.

Po ashtu drejtues i Qendrës për Kërkime, Studime në Edukimin Fizike, Sport dhe Shëndet-CRSPES. Ideator dhe kordinator i katër projekteve hulumtimeve kërkimore në fushën e Edukimit Fizik, Sportit dhe Shëndetit.

Autor i kapitullit në librin “Sport Technology” me titull “Application of basketball game models through sports technology” shtëpia botuesi IntechOpen London-United Kingdom.

Anëtar i bordit në revistën European Journal of Sport & Science in Sports në Tiranë dhe recensues i revistës The Open Sports Sciences Journal-Portugali në dy punime.

Më poshtë arritja e deritanishëme shkencore, referimet dhe artikujt të Mr. Sc. Artan R. Kryeziut:

Konferenca-simpoziume shkencore:

1. Artan Kryeziu (2016). Factorial structure of basic motor and situational tests of basketball players aged 14-15 years. Medunarodni Kongres, Sport i Zdravlje Zbornik Naučnih i Stručnih Radova, At Tuzla, Bosna and Hercegovina 9, 202-207.
2. Bujar Begu, Artan Kryeziu, Jeton Havolli (2017). Effect of plyometric program for 12 weeks of age 17-18 years in Basketball. Fourth International Balkan Conference in Sport Sciences - IBCSS2017. University of Tetova. Tetova, Macedonia, 4, 5.
3. Artan Kryeziu, Bujar Begu, Isa Asllani (2017). Impact of the four week plyometric training program on boosting explosive strength and agility for basketball players. Fourth International Balkan Conference in Sport Sciences-IBCSS2017. University of Tetova. Tetova, Macedonia, 4, 5.

4. Artan Kryeziu (2017). Differences between children from urban and rural areas of morphological performance and motor test. International Conference on Exercise, Sport & Health (ICESH2017) in Tirana, Albania, 2.
5. Artan Kryeziu, Buja Begu, Isa Asllani, Enver Tahiraj (2017). Comparison of body mass index between 16 and 17 year olds in basketball players. 5 International Balkan Conference in Sport Sciences, IBCSS2018. Tetovo, Macedonia, 5, 5.
6. Artan Kryeziu, Bujar Begu, Enver Tahiraj, Isa Asllani (2018). The effect of physical education curriculum between initial and final measurement in the body mass index (BMI) at age 13, 14 and 15 years female. 15th International Scientific Conference on Transformation Process in Sport "Sport Performance" Montenegrin Sports Academy: Budva-Montenegro. 15, 69.
7. Artan R. Kryeziu (2019). Differences between age groups 12, 13 and 14 in EUROFIT tests. 6th International Balkan Conference in Sport Sciences, 6, 13.
8. Artan R. Kryeziu, Bujar Begu, Isa Asllani (2019). Aerobic-anaerobic performance of basketball players according to U-18 game positions. 6th International Balkan Conference in Sport Sciences. 6, 15.
9. Bujar Begu, Artan R. Kryeziu, Abedin Bahtiri (2019). Correlations of anthropometric variables and motor basic situational tests to basketball players of 14-15 Years 6th International Balkan Conference in Sport Sciences. (6) 9.

Publikimet në revista ndërkombëtare:

1. Artan Kryeziu, Isa Asllani (2015). The influence of some morphological variables and motor skills in the success of the junior basketball league. Published in Journal of Physical Activity & Sports, JPAS Tirana, Albania, 2(2); 3-9.
2. Artan Kryeziu, Isa Asllani (2016). Differences in some motor skills of basketball positions according to 16 year olds. International Scientific Journal of Kinesiology. Acta Kinesiologica, Kroacia, 10 (2); 26-30.
3. Artan Kryeziu, Isa Asllani (2016). The structure of morphological characteristics and basic motor skills of the typical game of basketball junior. European Journal of Health & Science in

Sports. 3(2); 7-10.

4. Bujar Begu, Artan Kryeziu, Jeton Havolli (2017). 12-Week effect of plyometric program in ages 17-18 years in basketball. *Sport and Health, International Journal of Sport Sciences and Health*, 4 (7-8): 22.
5. Artan Kryeziu, Bujar Begu, Enver Tahiraj, Isa Asllani (2018). Comparison of Body Mass Index between 16 and 17 years of Age in Basketball Players Game. *International Journal of Sport Sciences and Health, Sport and Health*. Vol. 5 No.9-10.
6. Bujar Begu, Artan R. Kryeziu, Fadil Nika (2018). The Influence of anthropometric and motor variables in test of situational accuracy to cadet players of basketball game. *International Journal of Sport Sciences and Health, Sport and Health*, 5 (9-10): 55-61.
7. Bujar Begu, Artan Kryeziu, Abedin Bahtiri (2018). Impact of anthropometric variables in agility ability young basketball. *International Scientific Journal of Kinesiology. Sport science, Kroacia* 11 (1): 57-60.
8. Bujar Begu, Artan Kryeziu, Jeton Havolli (2018). Latent structure of the morphological characteristics motor basic and situational test of basketball game 14-15 years. *Sport Mont*. 16 (6): 69-74.
9. Artan Kryeziu, Bujar Begu, Isa Asllani (2018). Structure of morphological characteristics to young basketball player. *International Scientific Journal of Kinesiology. Sport Science, Kroacia*. 11 (1) pp. 61-63.
10. Artan Kryeziu, Bujar Begu, Fadil Nika (2018). The effect of a 30-Day Plyometric Training Programme on increasing of Explosive Strength and Agility Strength in Basketball Players. *International Scientific Journal of Kinesiology, Sport Science*, 11 (1); 107-113.
11. Artan Kryeziu, Isa Asllani (2019). The effect of between initial and finale measurement in the body mass index at women. *Scientific Journal of Kinesiology Sport Science* 12(1); 102-105.
12. Artan Kryeziu, Bujar Begu, Isa Asllani, Astrit Iseni (2019). Effects of the 4 week plyometric training program for basketball players. *Turkish Journal of Kinesiology*. 5 (2) 110-116.
13. Kryeziu, Artan (2019). Morphological Differences of Kosovo Basketball Players According to Team Positions. *International Journal of Applied Exercise Physiology*, 8(4), 8-12.
14. Kryeziu, Artan (2020). Applying the weekly plyometric model to jumping and agility in young basketball players. *Sport Science* 13 (1): 127-131

Hulumtime/Kërkime shkencore

- Punimi i Diplomës (2010) “Vlerësimi i disa dimensioneve morfologjike dhe motorike te basketbollistët e moshës 17 vjeçare” Kolegji Iliria, Fakulteti i Kulturës Fizike, Sportit dhe Rekreacionit.

- Tema e Magjistraturës: (2015) “Analiza e pozicioneve të lojtarëve në bazë të disa karakteristikave morfologjike dhe testeve lëvizore bazike e situacionale tek basketbollistët e moshës 16-17 vjeçare” Fakultetin e Kulturës Fizike, Universitetin e Tetovës.

Disertacioni me titull: *Analiza e pozicioneve të lojtarëve në basketboll në bazë të karakteristikave morfologjike dhe testeve aerobo-anaerobe* merret me problematiken e analizës së pozicioneve si dhe dallimet domethënëse ndërmjet pesë grupeve të përcaktuara sipas pozicioneve të lojtarëve të lojës së basketbollit.

Në mënyrë specifike është trajtuar zhvillimi historik i lojës së basketbollit dhe analiza e zhvillimit të lojës së basketbollit, më pastaj janë analizuar pozicionet e lojës sipas pozicioneve të lojtarëve në strukturën antropologjike hapësirën morfologjike, aftësitë motorike bazike e situacionale (specifike) tipike të lojës, aftësitë anaerobe dhe aerobe-funksionale për basketbollistët.

Pesha e këtij problemi do të jet një kontribut modest që të njihet në mënyrë më gjenerale loja e basketbollistëve te të rinjë sipas pozicioneve të lojës. Po ashtu është hulumtuar, për këtë problematikë, me qëllim që të japim një kontribut dhe të njohim sa më mirë lojën e basketbollit, përformancën morfologjike, aftësitë motorike bazike e situacionale, aftësitë anaerobe dhe aftësitë aerobo-funksionale sipas pozicioneve të lojtarëve, me studim të veçantë në superligën U-18. Mund të thuhet se loja e basketbollit brenda vetes ka strukturë të rëndësishme të zhvillimit, pastaj rritja e kërkesave të mëdha për profilizimin, që janë kërkesat kryesore për basketbollistët e ardhëshëm. Duhet theksuar se specializimi i lojtarëve të basketbollit me dimensionet antropologjike është kërkesë bashkëkohore e sportit të basketbollit, në të cilën manifestohet përformanca morfologjike, aftësia motorike bazike, aftësia situacionale tipike në lojë, pastaj, aftësitë anaerobe dhe aftësitë aerobo-funksionale të cilat janë të rëndësishme në ngritjen e përformancës së një lojtari në një pozicion dhe me detyra të caktuara.

Në kapitullin e parë ka paraqitur analizën e pozicioneve të lojtarëve sipas strukturës antrologjike të lojtarëve, në të cilën veç e veç janë përshkruar organizatori i lojës-PG, anësori realizator-SG, anësori i shpejtë-SF, anësori i gjatë-PG dhe qendra-C. Në punim përshkruhen dhe shpëgohen teoritikisht konceptet dhe nocionet bazë të termeve nga struktura antropologjike, duke përfshirë performancën antropometrike (morfologjike) me dimension longitudinal dhe transversal të skeletit, të volumit e të masës së trupit dhe të indit dhjamor nënlëkuror. Me pastaj është shkruar për strukturën e aftësitëve motorike siç janë: forca si aftësi motorike, shpejtësia, qëndrueshmëria, agjiliteti, koordinimi dhe preciziteti. Tek performanca aerobo dhe anaerobe janë përshkruar këto dy denificione veç e veç në mënyrë kornologjike.

Po ashtu në këtë kapitull janë paraqitur edhe hulumtimet e deritanishme, që janë realizuar në vende të ndryshme dhe tek trevat tona, duke dhënë një pasqyrë të qartë të karakteristikave morfologjike, aftësive motorike bazike e situacionale tipike të lojës, performanca aerobo dhe anaerobe. Në të cilët janë paraqitur publikimet shkencore prej të cilave janë nxjerr hulumtimet më të rëndësishme të dallimeve domethënëse të përcaktuar sipas pozicioneve të lojës.

Në kapitullin e dytë të këtij disertacioni autori ka përcaktuar lëndën e hulumtimit me të cilën e trajtojmë analizën e pozicioneve të lojtarëve të basketbollit në bazë të karakteristikave morfologjike dhe testeve aerobo-anaerobe. Pastaj përmes qëllimit kryesor të këtij hulumtimi ka të bëjë analizën e karakteristikave morfologjike dhe performancën aerobo-anaerobe, si dhe për të vëretuar dallimet domethënëse sipas pozicioneve të lojtarëve të lojës së basketbollit, si dhe qëllime të tjera të veçanta. Gjithashtu ka paraqitur edhe detyrat e hulumtimit për secilën hapësirë veç e veç.

Më pastaj metodologjia e hulumtimit në të cilën janë përfshirë mostra e subjekteve dhe variablave me përshkrimin e tyre veç e veç. Në këtë rast si subjekte janë përfshirë 115 basketbollistë të ndarë në pesë pozicione kryesore në lojën e basketbollit. Mosha e pjesëmarrësve, në studime mesatarisht është 17.14 vjeç meshkujt në superligën U-18, të cilët janë pjesëmarrës aktiv në lojën e basketbollit, që zhvillojnë gara kampionale nën organizimin e Federatës së Basketbollit të Kosovës. Në mostrën e subjekteve janë përfshirë të rinjët nga klubet e Republikës së Kosovës të cilët janë: Klubi i basketbollit "Z - Mobil" nga Prishtina, K.B. "Keresan-Prishtina" nga Prishtina, K.B "M-Junior" nga Prishtina, K.B. "Borea" nga Peja, K.B. "Penza" nga Peja, K.B. "Trepça" nga Mitrovica, K.B. "Vushtrria Basket" nga Vushtrria, K.B.

“Rahoveci” nga Rahoveci, K.B. “Istogu” nga Istogu dhe K.B. “Lipjani” nga Lipjani. Në hulumtim gjithashtu basketbollistët janë ndarë sipas pozicioneve kryesore të lojës, për të analizuar veç e veç pesë pozitat, përfëshirë si subjekte me sa vijon: Organizatori i lojës-PG (n=23), Anëtori realizator-SG (n=23), Anëtori i shpejtë-SF (n=23), Anëtori i gjatësisë -PF (n=23) dhe Qendra-C (n= 23).

Mostra e instrumenteve matëse që ka aplikuar është ndarë sipas grupeve si vijim: Instrumentet matëse për vlerësimin e karakteristikave morfologjike; Instrumentet matëse për vlerësimin e testeve motorike bazike; Instrumentet matëse për vlerësimin e testeve motorike situacionale; Instrumentet matëse për vlerësimin e parametrave anaerobe; Instrumentet matëse për vlerësimin e parametrave aerobe-funksionale. Autori po ashtu, karakteristikat morfologjike i ka vlerësuar me TANITA BC-545, ndërsa testet motorike, aerobe dhe anaerobe janë vlerësuar me Microgate të prodhimit Witty Manager Timing System, ndërsa parametrat funksional me apart të shtypjes së gjakut janë matur me pulsionetër të tipit “OMRON”.

Me tutje autori ka paraqitur procedurat për llogaritjen e formulave dhe koeficientëve për informacione më të rëndësishme për matjen e performancës morfologjike-antropometrike në të cilën janë përfëshirë indeksimet, matjet motorike bazike e situacionale (specifike) tipike të lojës së basketbollit, pastaj parametrat anaerobe në të cilën janë përshkruar veç e veç në realizimin e kapaciteti dhe fuqisë anaerobe dhe të vlerës maksimale të oksigjenit (VO₂max).

Në kapitullin e tretë ka vendosur rezultatet e punimit për të gjitha matjet në parametrat themelor në të cilën ka paraqitur 10 tabela prej tyre gjysmën i ka paraqitur sipas pozicioneve të lojës, që të gjitha janë analizuar për secilën strukturë antropologjike.

Tek rezultatet e analizës komparative ka analizuar dhe interpretuar veç e veç secilën tabelë së pari përmes analizës univariante të variancës (ANOVA), pastaj ka përdoruar analizën univariante të variancës (ANOVA) dhe analizën multivariante të variancës në të cilën janë paraqitur në 10 tabela në të cilat është shtjelluar përcaktimi i dallimeve domethënëse sipas pozicioneve të lojës. Në tabelat e analizës univariante të variancës (ANOVA) analizës multivarinte e variancës (MANOVA) të variablave të aplikuara në manifeste morfologjike, ndërmjet grupeve sipas pozicioneve të lojës. Nga mund të vërtetohen dallimet domethënëse ndërgrupore në mesataren aritmetikore të variablave të analizuara. Sipas kësaj, autori ka analizuar Lambda e Wilks', rrënja

më e madhe e Roy's, shallën e lirisë (Df) dhe dallime domethënëse. Më pastaj në aftësitë motorike janë vërtetuar dallimet domethënëse ndërgrupore të mesatares aritmetikore të testeve të analizuara. Tek parametrat anaerobe ndërmjet grupeve sipas pozicioneve të lojës dhe tek parametrat aerob dhe funksional në mes grupeve sipas pozicioneve të lojës.

Përmes analizës univariante të kovariancës (ANCOVA) dhe analizës multivariante të kovariancës (MANCOVA) karakteristikat morfologjike janë paraqitur 5 tabela. Në Lambda e Wilks's, rrënja më e madhe e Roy's, shkalla e lirisë (Df) dhe dallimet domethënëse. Përmes kësaj analize vërtetohet përcializimi pjesëmarrës i dallimeve ndërmjet grupeve sipas pozicioneve të lojës.

Po ashtu përmes analizës faktoriale latente është paraqitur rrënjët kryesore karakteristike (LAMBDA), sipas metodës së Hotteling-ut dhe të kriterit GK (Gutman-Kaiser), janë ekstrahuar komponente kryesore, në sistemin morfologjik, motorik bazik dhe situacional tipik të lojës, aftësive aerobo-anaerobe dhe funksionale. Përveç ekstrahimit të faktorëve morfologjik, motorik bazik dhe situacional tipik të lojës aftësive aerobo-anaerobe dhe funksionale. Një rëndësi mjaft të madhe i është kushtuar edhe analizës kanonike diskriminative ku janë testuar dallimet shumëdimensionale (faktorët e matur në grup) ndërmjet grupeve të testuara dhe janë potencuar faktorët që e bëjnë diskrimin më të mirë të grupeve. Të cilat përmbajnë këto të dhëna: Numrin e funksioneve diskriminues (F_{cn}), Rrënjën karakteristike të ekuacionit (λ), Koeficientin e korelacionit kanonik (R_c), Wilks' λ - i cili cakton kriterin për forcën diskriminuese të variablave të aplikuara, Bartlet X^2 testin - që teston rëndësinë statistikore të ekuacionit diskriminues, Shkallët e lirisë (Df), Niveli i rëndësisë së ndryshimit të funksionit diskriminues (Sig.). Pastaj veç e veç ka paraqitur diskutimin e këtyre të dhënave të paraqitur në tabelat e strukturës antropologjike.

Në fund kapitujve ka përfshirë përfundimet dhe rekomandimet në këtë disertacion nga të cilat janë nxjerrë rezultatet dhe konstatimet gjatë kësaj pune shkencore për analizën e pozicioneve të lojtarëve sipas pozicioneve të lojtarëve.


Përfundimi dhe propozimi


Disertacioni i doktoraturës me titull: "Analiza e pozicioneve të lojtarëve në basketboll në bazë të karakteristikave morfologjike dhe testeve aerobo-anaerobe" i kandidati Mr. Sc. Artan R.


Kryeziu sjell një studim të mirëfillt kërkimor-shkencor në fushën e Kineziologjisë. Përmes këtij studimi të fushës së Kineziologjisë është sjellur një punë përshkruese, analizuese dhe kërkimore-shkencore me vlera, në përcaktimin e pozicioneve të lojtarëve sipas strukturës antropologjike që të zbatohet në teorinë dhe praktikën e basketbollit. Ky punim i disertacionit ka një peshë dhe kontribut të jashtëzakonshëm në profilizimin dhe specializimin e lojtarëve sipas pozicioneve të lojtarëve, me studim të veçantë në superligën U-18, e cila në trevat tona ka munguar. Në këtë disertacion të cilën kandidati ka dituar t'i shjelloj më një meshtri profesionale dhe shkencore definimin e strukturës antropologjike të pozicioneve të lojës së basketbollit, e të cilët janë arritur përmes rezultateve dhe përfundimeve të sakëta e të theksuara në ngritjen e performancës së lojtarëve të një pozicioni të caktuar në brendësi të ekipit.


Në bazë të kësaj që është thënë me sipër. Komisioni për vlerësimin e disertacionit të doktoraturës me titull: “Analiza e pozicioneve të lojtarëve në basketboll në bazë të karakteristikave morfologjike dhe testeve aerobo-anaerobe” i kandidati Mr.Sc. Artan R. Kryeziut, konstaton se ky disertacion i doktoraturës i plotëson të gjitha kriteret shkencore të përcaktuara dhe i propozon Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit të Kulturës Fizike të Universiteti të Tetovës që ta miratojë këtë raport dhe ta lejojë mbrojtjen publike.

Komisioni:

1. Prof. Dr. Besnik Telai - Kryetar 

2. Prof. Dr. Metin Dalip - anëtar 

3. Prof. Dr. Atli Koleci - anëtar 

4. Prof. Dr. Visar Ganiu - anëtar 

5. Prof. Dr. Isa Asllani - Udhëheqës 